



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0001

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërje Vedat Poterqoi si Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani dhe Isa Hasani si anëtar, duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik “Construmax” Sh.P.K. të datës 03.01.2024 si dhe mbi ankesën e operatorit ekonomik ankues "Alfa I" Sh.P.K. të datës 05.01.2024 kundër Njoftimit mbi Vendimin e datës 13.12.2023 të Autoritetit Kontraktues- Komuna e Prishtinës për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndërtimi i Therrtores Publike” me numër të prokurimit 616-23-141-511, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë 15.04.2024 merr këtë:

Vendim

1. Aprovohen si pjesërishtë të bazuara ankesa e grupit te operatoreve ekonomik “Construmax” Sh.P.K. & Harst Group Sh.P.K. & Ebk Sh.P.K me nr. 2024/0001 e datës 03.01.2024 dhe ankesa e operatorit ekonomik “Alfa I” Sh.P.K. me nr. 2024/0014 e datës 05.01.2024, vendimi i AK - Komuna e Prishtinës për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndërtimi i Therrtores Publike” me numër të prokurimit 616-23-141-511, anulohet, ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim.

2. Obligohet Autoriteti Kontraktues- Komuna e Prishtinës për zbatimin e këtij vendimi si dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të vendimit të dërgoj në OSHP njoftimin lidhur me veprimet që ndërmerren për zbatimin e tij, të gjitha këto nën paralajmërimin se në rast të moszbatimit të këtij vendimi, OSHP do të ndërmerr masat kundër Autoritetit Kontraktues në përputhje me nenin 131 të LPP.

3. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohen operatorët ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtroj kërkesë për kthimin e tarifës së ankesës në përputhje me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 27.07.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i Therretores Publike” me numër të prokurimit 616-23-141-511.

Me 13.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka njoftuar anulimin të aktivitetit të prokurimit.

Me 18.12.2023 Grupi i operatoreve ekonomik ankues "Construmax" Sh.P.K. & Harst Group Sh.P.K. & Ebk Sh.P.K. të përfaqësuar nga "Construmax" Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 26.12.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar këtë kërkesë për rishqyrtim. Me datë 03.01.2024 operatori ekonomik ankues "Construmax" Sh.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/01.

Me datë 18.12.2023 operatori ekonomik ankues "Alfa I" Sh.P.K, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 26.12.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar këtë kërkesë për rishqyrtim. Me datë 05.01.2024 operatori ekonomik ankues "Alfa I" Sh.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/14.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesat i përmbajnë elementet e parapara me nenin 111 të LPP dhe janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP, pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP. Meqë ankuesit ka statusin e palës së interesuar sipas nenit 4 paragrafi 1, nën-paragrafi 26 të LPP, kurse ankesat janë ushtruar në harmoni me dispozitat e cituara si më sipër, të njëjtat bijnë nën kompetencat e këtij Organi përkitazi me shqyrtimin dhe vendosjen në mënyrë meritore, në kuptim të nenit 105 të LPP.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 01/24 dhe ankesa nr. 14/24 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

-Vlerësimi dhe administrimi i provave-

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 05.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesave me Nr.2024/0001 dhe Nr.2024/0014 ndërsa me datë 20.01.2024 janë dorëzuar raportet e ekspertizës të ekspertit shqyrtues.

Lidhur me ankesën nr. 2024/0001 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet dhe të gjeturat në këtë ekspertizë, eksperti shqyrtues profesional i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e GOE Construmax Sh.P.K & Harst Group Sh.P.K. & Ebk Sh.P.K. të aprovohet si e bazuar, të anulohet Vendimi i AK-Komuna e Prishtinës për Anulim të Aktivitetit dhe lënda të kthehet në rivlerësim ku duhet të kërkohen sqarime shtesë sipas Neni 72

Dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe Udhëzuesit 001/2023”.

Lidhur me ankesën nr. 2024/0014 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet dhe të gjeturat në këtë ekspertizë, eksperti shqyrtues profesional i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e GOE Alfa I sh.p.k. të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet Vendimi i AK-Komuna e Prishtinës për Anulim të Aktivitetit dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Kjo ekspertizë ndërlidhet edhe me ekspertizën 001/2024 dhe se lënda duhet të kthehet në rivlerësim duke vepruar ne përputhje me Udhëzuesin 001/2023 dhe nenin 72 të LPP-së”.*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues nuk është deklaruar për mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues, ndërsa Operatori ekonomik është pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues.

Palët janë në dijeni lidhur me shkresat e kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores së cituar dhe konstatohet se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP. Prandaj Paneli analizoi në vijim shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe pohimet e tyre konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme dhe ka kushte të vendoset në mënyrë meritore përkitazi me ankesat në rastin konkret, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Në këtë rast Paneli mori paraprakisht konstatoi se AK ka zbatuar:

- a. procedurë të hapur, sikurse përkufizohet me paragrafin 1.37. të nenit 4, të LPP;
- b. lloji i kontratës: Punë, sikurse parashihet me paragrafin 3, të nenit 27, të LPP;
- c. vlera e parashikuar e kontratës: 3,500,000.00 € vlere e madhe, sikurse përkufizohet me paragrafin 1.28 të nenit 4, lidhur me paragrafin 1, të nenit 19, të LPP
- d. Kriteri i dhënies së kontratë është çmimi ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas peshës së kritereve të përshkruara në Aneksin 6 të dosjes së tenderit.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Paneli shqyrtues (në përbërje kolegjiale) administroi me të gjitha shkresat e kësaj lënde, duke i analizuar të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e palëve të cilat (në përmbledhje) i shqyrtoi si në vijim:

Pohimet ankimore te Ankuesit "Construmax" Sh.P.K. & Harst Group Sh.P.K. & Ebk Sh.P.K

Paneli shqyrtues do të lëshohet vetëm në pretendimet ankimore të cilat janë përcaktuese sa i përket marrjes së vendimit meritator lidhur me këtë ankues, si në vijim:

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur rreth eliminimit të ofertës së tij/saj me arsyetimin se në Dosje të Tenderit është kërkuar *“OE duhet te ofroje një deklaratë te vulosur dhe nënshkruar për Grancionin nga prodhuesi min. 1 vite për pozicionet e kërkuara”* mirëpo ju keni dorëzuar deklaratën e nënshkruar nga vet si operatorë, andaj i njëjti kusht nuk plotësohet. Lidhur me këtë eksperti shqyrtues konstaton se bazuar në përshkrimin e kësaj dëshmie të kërkuar dokumentare, është konstatuar se ofertuesit duhej të ofronin një deklaratë të vulosur dhe nënshkruar për garancionin, në vend që të ofronin vetëm garancione nga prodhuesi. Ky konstatim është mbështetur edhe më tej duke pasqyruar faktin se

çdo ofertues kishte mundësinë të ofronte garancion nga 1 deri 10 vite, dhe të gjithë ofertuesit kishin ofruar garancione mbi 3 vite, duke i fituar pikët e nevojshme. Konkluzionet se pretendimi i dytë i GOE-së Construmax & Harst & Ebk ankues është i mbështetur, duke qenë se ata kanë ofruar deklaratë të nënshkruar dhe të vulosur për garancionin për një periudhë prej 10 vitesh, duke theksuar se edhe në mungesë të garancionit të produktit për 10 vite, ata do të ofrojnë shërbim apo furnizim të ri të produkteve brenda kësaj periudhe 10-vjeçare. Konstatohet se ky pretendim është i mbështetur në faktet e prezantuara. Sipas këtyre informacioneve, eliminimi i këtij grupi ofertues me këtë arsye është i paqëndrueshëm, pasi që grupi ofertues ka plotësuar kërkesën e specifikuar nga Dokumentacioni i Tenderit. Paneli Shqyrtues këtë konstatim të ekspertit shqyrtues e mbështet pjesërisht ngase eksperti shqyrtues largohet paksa prej kërkesës së Dosjes së Tenderit dhe anon më tepër tek dëshmia që duhet të ofroj OE lidhur me këtë kërkesë, po ashtu, dokumentin të cilën eksperti shqyrtues e konsideron “deklaratë të nënshkruar dhe të vulosur për garancionin për një periudhë prej 10 vitesh”, sipas Paneli Shqyrtues dhe asaj që mund të shihet, ky dokument titullohet si garancion, i cili është i nënshkruar nga Grupi i OE e jo nga prodhuesi. Andaj, Paneli Shqyrtues për këtë dokument konsideron se duhet të kërkohen sqarime konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP, sepse mungon ky garancion nga prodhuesi siç ka qenë kërkesë e Dosjes së Tenderit, pasi që GOE posedon deklaratë të vulosur dhe të nënshkruar për garancionin nga prodhuesi, andaj, pretendimi kualifikohet si pjesërisht i bazuar dhe GOE-së Construmax & Harst & Ebk, dhe për këtë AK në fazën e ri-vlerësimit të kërkoj sqarime shtesë.

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur rreth eliminimit të ofertës së tij/saj me arsyetimin se: “*Dyert e frigodhomave- pozicionet në BoQ 12.11-12.18 → ISO 9001÷ISO 14001 ÷ ISO 22001 ÷ ISO 45001 janë të skaduar afatet*” “Dritaret →pozicioni në BoQ 12.1-12.10 → ISO 9001 e skaduar (01.04.2015) dhe certifikata vetëm ne gjuhen polake”; “VRF- pozicioni ne BoQ 29.11-30.1 →ISO 9001 e skaduar, autorizimi nuk është i dhënë as nga prodhuesi e as nga distributori i autorizuar (është i dhënë nga Service provider), Certifikata e Eurovent është e skaduar 31.07.2020, Ne autorizimin e prodhuesit (distributorit) nuk eshte e cekur titulli projektiti, numri i prokurimit si dhe nuk ka date autorizimit”; “Gypat për ujësjellës →pozicioni ne BoQ 17.8-17.10 →autorizimi nga distributori nuk ka datë të lëshimit”; “Njësit për friza → pozicioni ne BoQ 28.1-28.14→ISO 9001÷ISO 14001÷ISO 22001÷ISO 45001 janë të skaduar afatet”. Sipas ekspertit shqyrtues GOE ankues kanë paraqitur certifikatat e ISO të prodhuesit me vlefshmëri të përputhur me kërkesat e specifikuar në Dokumentacionin e Tenderit. Autoriteti Kontraktues ka eliminuar padrejtësisht këtë GOE duke u bazuar në certifikata të prodhuesve të tjerë, pa kërkuar ose zbatuar sqarime të lejuara me Ligjin e Prokurimit Publik sipas kërkesave të Dokumentacionit të Tenderit. GOE Construmax&Harst&Ebk në fjalë ka plotësuar Kërkesat e specifikuar në Dokumentacionin e Tenderit, por është eliminuar në mënyrë të padrejtë. Paneli Shqyrtues konsideron se AK ka mundur të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP.

Paneli sqaron po ashtu se në vështrim të kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat precizohen në dosjen e tenderit dhe si të tilla bëhen publike për të gjithë ofertuesit eventual, secili duhet të udhëhiqet nga parimi i kujdesit në përmbushjen e kushteve formale në kohë dhe brenda afatit.

Ankuesi po ashtu pretendon rreth papërgjegjshmërinë së OE Alfa I shpk, duke e kategorizuar si të qëndrueshëm arsyetimin nga AK se trupi ndriçues i pozicionit 26.5 nuk plotëson kërkesat dhe specifikat e BoQ është i qëndrueshëm dhe meritohet pasi që në katalogët e këtij prodhuesi nuk ka reflektor me ndriçues 100W e as 150LM/W, e as nuk e ka shpërndarjen e dritës prej 25 107W 157 LM/ W , nuk e plotëson as rezistencën në temperaturë të kërkuar po ashtu nuk e ka as mbrojtjen e kërkuar IP 66 mirëpo e ka IP 65. Këto pretendime Paneli Shqyrtues i kualifikon si

pjesërisht të bazuar dhe AK në fazën e ri-vlerësimit të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP dhe nenit 10 të Udhëzuesit Nr.01/2023 për Prokurim Publik, mund të kërkojen sqarime shtesë, si dhe për një pjesë të këtyre pretendime Paneli Shqyrtues shpjegimin do ta jap më poshtë tek konstatimet e Panelit Shqyrtues rreth pretendimeve ankimore në ankesën me Nr. 2024/0014.

Paneli shqyrtues nuk do të lëshohet në pretendimet ankimore ndaj OE tjerë të cilët janë të eliminuar dhe të cilët nuk kanë paraqitur ankesë në OSHP, ngase të njëjtit janë pajtuar me eliminimin e tyre dhe nuk mund të kualifikohen në fazën e ri-vlerësimit si palë me interes.

Pohimet ankimore të OE ankues "Alfa I" Sh.P.K

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka vendosur rreth eliminimit të ofertës së tij/saj, ku sipas AK: "katalogut te prezantuar nuk ka produkte te cilat e plotësojnë kushtin sipas përshkrimit teknik dhe paramases ne pozicionin 26.5. Eficienca kërkohet te jete 150LM/W ose 15000LM ndërsa OE ka prezantuar produktin ne katalog me eficiency nga 163LM/W"; "Temperatura punuese -40°C + 35°C nuk e plotëson kërkesën specifike teknike te detyrueshme sepse është kërkuar +50°C". Ngjashëm site arsyeja e pare për eliminim, as këtu nuk është kontestuese qe ne kemi ofertuar me temperature -40* deri +35°C."; "IP 65 nuk është ne përputhje me kërkesën specifike teknike te detyrueshme e cila duhet te jete minimum IP 66, një karakteristike shume e rëndësishme për trupin ndriçues". Lidhur me këtë Eksperti Shqyrtues deklaroi se pretendimi ankimore nuk është i qëndrueshëm, pasi vërehet në formën tabelare se produkti i prezantuar në ofertë nuk përmbush disa specifika të pozicionit 26.5 të specifikimeve në paramasën e DT, dhe tenderi i OE Alfa I shpk duhej të refuzohej menjëherë sipas nenit 10 të Udhëzuesit nr.01/2023 për Prokurim Publik. Paneli Shqyrtues nuk i mbështet konstatimet e ekspertit shqyrtues ngase këto konstatime nuk janë të mbështetura sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit dhe për më tepër Paneli Shqyrtues nuk do të lëshohet edhe në specifikime teknike të cilat OE nuk është eliminuar nga ana e AK dhe nuk ka as pretendime ankimore nga ana e ankuesit, duke u bazuar në nenin 108/A dhe 109 të LPP.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në letrën standarde për tenderuesit e eliminuar me çrast AK ka paraqitur përveç parametrave të OE ankues edhe pjesën tabelare të specifikacionit teknik për pozicionin 26.5, të njëjtat janë të konfirmuara edhe në ankesën e ankuesit. Andaj, Paneli Shqyrtues pretendimin ankimor e kualifikon si të bazuar për shkak se për pozicionin 2.6 janë kërkuar këto specifika (\geq) 150LM/W është simbol matematikor i cili lexohet "me i madh ose i barabarte me" dhe OE i ka sjellë konform specifikave 163LM/W, ashtu, sikurse tek arsyeja tjetër e eliminimit ku është kërkuar (\geq) -40°C deri ne +50°C dhe OE ka ofertuar -40°C deri ne +35°C, kështu që nuk qëndrojnë arsyet e AK se është kërkuar saktë 150LM/W respektivisht +50°C. Si rrjedhojë Paneli Shqyrtues e mbështet deklaratën e ankuesit se ne këtë faze nuk mund te thuhet se kjo shpërndarje është e papërshtatshme aq me pak duke mos treguar pse qenka e papërshtatshme, ku vet AK e ka vendosur kërkesën e tille ne DT.

Ndërsa për pretendimit tjetër i ankuesit sa i përket arsyes tjetër të eliminimit se oferta e ankuesit nuk është ne përputhje me kërkesën specifike teknike te detyrueshme e cila duhet te jete minimum IP66, ankuesi deklaroi po ashtu se mbrojtja e trupit ndriçues me te cilin kemi ofertuar ne është saktësisht IP65 qe ne fakt është ekuivalente me IP66. Pra dallimi ndërmjet IP65 dhe IP66 është aq i papërfillshëm sa qe këto intervale te mbrojtjes si te tilla konsiderohen ekuivalente. Sidoqoftë, ne rastin konkret kemi te bëjmë me një devijim te vogël ne kuptim te nenit 59 par. 4 te LPP lidhur me nenin 45 par. 19, 20 dhe 21 te RRPP. Pra duke marre parasysh

faktin që të gjitha kërkesat tjera të dosjes së tenderit janë përmbushur në tërësi, ndikimi i këtij devijimi është totalisht i papërfillshëm. Me këtë rast duhet cekur se dallimi i ofertës tone me ofertat tjera në çmimin është se në jemi rreth gjysmë milioni euro me të lira se të gjitha ofertat tjera. Sidoqoftë ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me ndërtimin e thetores publike të Kryeqytetit. Fakti që në një nën pozicion lidhur me fuqinë mbrojtëse të njerit prej ndriçuesve ku në kemi ofertuar me IP65 dhe jo me IP66, është totalisht i papërfillshëm për ndërtimin e thetores publike për të cilën është shpallur ky aktivitet i prokurimit. Pra ky devijim është një devijim i vogël në kuptim të nenit 59 par. 4 të LPP dhe nenit 45 par. 19, 20 dhe 21 të RRPP Nr.001/2022. Rrjedhimisht në nuk mund të eliminohejmë nga konkurrenca për shkak të këtij devijimi të vogël sepse një devijim i tillë i vogël lejohet sipas ligjit në fuqi të prokurimit publik respektivisht dispozitave të përmendura ligjore si me sipër. Në rastin konkret dëshmitë e ofruar nga në nuk përbejnë largime substanciale dhe nuk dallojnë esencialisht nga kushtet dhe specifikimet e dosjes së tenderit, prandaj oferta jone është dashur të konsiderohet oferte e përgjegjshme. Po ashtu ky devijim nuk ndikon në kapacitetet funksionale dhe në ndryshim të kushteve të kontratës apo në performancë, prandaj është dashur të merret parasysh nga AK-se. Përtej pretendimeve ankimore të elaboruara si me sipër, duhet të potencojmë edhe faktin se kryesuesja e komisionit vlerësues e ka ndare mendimin e saj nga dy anëtarët e tjerë të komisionit vlerësues dhe nuk është pajtuar me rekomandimin e tyre që të anulohet ky aktivitet i prokurimit dhe që konsiderohemi e të papërgjegjshëm. Pra në raportin e komisionit vlerësues mund të evidentohet edhe mendimi i ndare i kryesueses së komisionit vlerësues e cila në mënyrë objektive dhe profesionale ka konstatuar se në jemi tenderuesi i vetëm i përgjegjshëm dhe me çmimin me të lire. Prandaj konsiderojmë se Paneli Shqyrtues me rastin e trajtimit të kësaj ankese duhet të marrë parasysh edhe këtë fakt - prove. Kryesuesja e komisionit realisht e ka sqaruar shumë qarte edhe të dy pikat tjera kur ka sqaruar shenjen \geq e barabartë ose me e madhe në lidhje me pozicionin 26.5 për ndriçuesin LED ku është kërkuar 2:150lm/W, ndërsa në kemi ofruar 163 lm/W. Pra në kemi ofertuar sipas kërkesës dhe arsyeja e eliminimit është e papabuar.

Paneli shqyrtues lidhur me pikën e tretë të eliminimit, pretendimin ankimore e kualifikon si pjesërisht të bazuar, pasi që pretendimet tjera ankimore janë të bazuara për të cilat AK nuk ju ka referuar drejtë specifikave të cilat vet i ka vendos dhe ky i fundit mund të jetë një devijim i vogël i cili mund të mos ndikoj në implementim të kontratës, por si do që të jetë paneli shqyrtues thekson faktin se në këtë rast vetëm AK gëzon të drejtën me LPP që të vejë në zbatim nenin 59.4 të cilën AK e ka në diskrecionin e tij/saj (devijimin e vogël), por Paneli Shqyrtues në kuptim të nenit 1 dhe nenit 6 të LPP dhe mos prolongimit të këtij aktiviteti të prokurimit, duke u nisur nga fakti se oferta e këtij ankuesi është dukshëm më e lirë dhe njëri nga anëtarët e komisionit të vlerësimit e ka nda mendimin që ky aktivitet të mos anulohet, atëherë, AK në konsultim me njësinë e kërkesë të vendos se a mund të konsiderohet devijim i vogël apo jo konform nenit 59.4 të LPP. Nëse jo, atëherë AK këtë aktivitet të prokurimit mund ta anuloj në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Ankuesi po ashtu pretendon rreth papërgjegjshmërinë së GOE Construmax & Harst & EBK, Këto pretendime Paneli Shqyrtues i kualifikon si pjesërisht të bazuar dhe AK në fazën e rivlerësimit të kërkojë sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP dhe nenit 10 të Udhëzuesit Nr.01/2023 për Prokurim Publik, mund të kërkojë sqarime shtesë, si dhe për një pjesë të këtyre pretendime Paneli Shqyrtues shpjegimin i ka japur më lartë tek konstatimet e Panelit Shqyrtues rreth pretendimeve ankimore në ankesën me Nr. 2024/0001.

Paneli shqyrtues nuk do të lëshohet në pretendimet ankimore ndaj OE tjerë të cilët janë të eliminuar dhe/ose të cilët nuk kanë paraqitur ankesë në OSHP, ngase të njëjtit janë pajtuar me

eliminimin e tyre dhe nuk mund të kualifikohen në fazën e ri-vlerësimit si palë me interes.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues në kuptim të nenit 1 dhe 7 të LPP, vendosi se mënyra më e mirë, më e drejtë dhe më e barabartë do të ishte që ky aktivitet i prokurimit të kthehet edhe njëherë në ri-vlerësim të ofertave të vetëm të këtyre dy OE ankues, me qëllim që të shtirren të gjitha mundësit ligjore duke i aplikuar edhe sqarimet shtesë.

- Përfundim-

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët konsideron se vetëm disa nga gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli. Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Paneli sqaron se përveç nenit 1,6,7,27,28 dhe 56 të Ligjit për Prokurim Publik, është e rëndësishme të theksohet se të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për procesin e aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit në përputhje me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Kanë përvojë të mjaftueshme në këtë fushë dhe janë pjesëmarrës të vazhdueshëm nëpër tendere që publikohen në Republikën e Kosovës, duke kontribuar në një aplikim të ndershem dhe të drejtë për të gjithë. Kjo siguron një garë të barabartë dhe të drejtë për të gjithë ofertuesit dhe shmang ndikimin në prolongimin e procedurave të prokurimit, me “kërkesa për sqarime të vazhdueshme nga ofertuesit” për dokumentacionet të cilat vazhdimisht i procedojnë për aplikime në ofertat e tyre.

Andaj, paneli sqaron se në këtë rast përgjegjësia bie mbi ofertuesin, i cili tenderon për të fituar. Sepse është evidente dhe e njohur për të gjithë, se në çdo rast të njoftimit për kontratë, secili ofertues i cili kanë paqartësi me kërkesat dhe me specifikat e kërkuara DT, do duhej që në fazën paraprake, ti kundërshtoj të njëjtat apo eventualisht të parashtroj pyetje apo të kërkojë sqarime nga AK.

Në këtë kontekst edhe sipas gjykimit të pavarur të këtij paneli, AK por as OE, nuk duhet të thirren në dispozita nënligjore që të kërkojë sqarime shtesë për dokumentacionin e ofertuesve në çdo rast, pasi siç u sqarua si më sipër të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për detyrimet dhe procedurat e aplikimit nëpër tenderë. Kjo siguron që procedurat e prokurimit të mbeten efikase dhe të përmbushin qëllimin e tyre të sigurimit të kontratave publike në mënyrë të rregullt dhe të drejtë për të gjithë palët e interesuara. Paneli sqaron po ashtu se në vështrim të kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat precizohen në dosjen e tenderit dhe si të tilla bëhen publike për të gjithë ofertuesit eventual, secili duhet të udhëhiqet nga parimi i kujdesit në përmbushjen e kushteve formale në kohë dhe brenda afatit.

Në fakt synimi i këtij aktiviteti të prokurimit i referohet dhe nenit 104 paragrafi 4 i LPP, sipas të cilit në ndërmarrjen e masave të përcaktuara në këtë Pjesë IX, OSHP duhet (i) të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik përderisa po ky aktivitet i prokurimit i është nënshtruar dy here procesit të rivlerësimit. Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur në konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitetet buxhetore. Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur konform legjislacionit në fuqi dhe natyrës së çështjes në rastin konkret duke e konsideruar po ashtu të drejtë dhe të arsyeshme edhe lejimin e mjeteve të deponuara në emër të tarifës ankimore, përfshirë dhe operatorët ekonomik të cilët janë provuar nga qasja në dokumente. Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - CONSTRUMAX SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: